

PROMOVOHET LIBRI: «KOSOVA. NJË ANALIZË JURIDIKE»

Politika cunqoi të drejtën ligjore të Kosovës për mëvetësi

Autori, Christian

Staub, gjatë

promovimit potenco

se Kosova me

kushtetutën e 74-tës, sa

i përket anës

normative ishte e

barabartë me njësitë

tjera federale, porse

fushatën nacionaliste e

Millosheviqit, si dhe

anashkalimi saj në

Konferencën e Dejtonit

, bën që pastaj situata

të kalojë në një

konflikt të haptë

Rexhep RIFATI

Më 22 tetor në Zentrum Karl der Grosse të Curyhut para një auditori shqiptar -ziceran u bë promovimi i librit: «Kosova. Një analizë juridike» (në origjinal: "Kosovo, eine rechtliche Analyse") të autorit Christian Staub. Organizuese e këtij eventi kulturor ishte Qendra profesionale për Migracion Pro Integra (www.prointegra.net), ndërsa që kryetari i saj, Osman Osmani foli për rrugëtimin jetësor të autorit, duke përmendur se:

Christian Staub (i lindur më 16 shtator 1962 në afërsi të Curyhut, është shtetas italian dhe zviceran) me shkrime merret qysh nga viti 1999 dhe se më parë është marrë me grumbullimin e materialit studiues dhe analizës së shoqërisë zvicerane, më vonë edhe të shoqërisë e politikës franceze dhe evropiane. Ndërsa që më vonë një pjesë të punës së tij krijuar në fushën e drejtësisë ia kushton edhe sistemit juridik në Kosovë, gjegjësisht periudhës kushtetutës së vitit 1974. Ai në librin e tij "Kosovo, eine rechtliche Analyse" (Kosova, një analizë juridike) duke i bërë një analizë juridike kësaj kushtetute nxjerr nga aktet të drejtën burimore që ka pasur Kosova për mëvetësi, si njëra nga 8 njësitë e barabarta të federatës së atëhershme jugosllave.

Autori edhe në rastin e librit përmendi se "Kosova ka pasur themelet e një shteti të mëvetësishtëm, të barabartë me të gjitha republikat e Jugosllavisë së atëhershme, bazuar në pjesën normative të kushtetutës së vitit 1974", por, sipas tij, ka qenë pjesa jo normative, ajo deklarative, politike që në praktikë e ka cunquar këtë mëvetësi, për çka edhe si pasojë



Autori, Christian Staub me publicistin, Faton Topalli

pasojë ngjarjet e bujshme deri tek konfliktet në ish-Jugosllavi.

Staub në bashkëpunim me publicistin Faton Topalli, bashkëpunues-marrës e organizator i disa ngjarjeve të bujshme politike në Kosovë në prag të rrënimt të autonomisë potenco i se është marrë me dykuptimësinë që ka pasur pozita juridike e krahinave në ish federatën jugosllave, ku edhe Kosova e Vojvodina, kanë gëzuar, një lloj "dyshtetësi", duke pasur paralelisht përfaqësuesit e tyre në organet republikane të Serbisë (ku kanë pas edhe të drejtën e vetos) dhe të Federatës, në kryesinë e së cilës si edhe republikat duke qenë të përfaqësuar me nga një anëtarë. Ndaj edhe me këtë rast z. Christian Staub, përsërit konkludimin e tij, si edhe në libër se: Kosova ka pasur mundësi teorike të shkëpus raportet me Serbinë, duke i ruajtur lidhjet vetëm me federatën.

Më tej Staub foli edhe për fushatën

nacionaliste që ndërmori Millosheviqi kundër Kosovës dhe shqiptarëve përmes përdorimit të forcës, me qëllim që nën tutelën e tij të fus dy krahinat e atëhershme, Kosovën e Vojvodinën, ndonëse edhe ato ishin juridikisht elemente të ish-federatës jugosllave. Autori si objektivi të një interesi të pamjaftueshëm për Kosovën e përmendi edhe vet Evropën e cila edhe në Konferencën e Dejtonit e anashkaloi çështjen e Kosovës, duke lënë që problemi i saj pastaj të eskalojë në një konflikt të armatosur me përmasa mjaft të mëdha sa u dashët të intervenojnë edhe forcat veriatlantike

Të pranishmit në këtë promovim i shtuan një sërë pyetjesh autorit, apo disa nga ta që ishin njohës të mirë të periudhës që trajtohej në libër, duke dhënë edhe vetë një ndihmesë të çmueshëm në begatimin e këtij eventi kulturor, e që paraqiste edhe një kontribut për ndriçimin e një periudhe me një peshë historike jo vetëm për Kosovën e Ballkanin, por edhe për ata që e neglizhuan për një kohë këtë problem.



Në bashkëpunim me publicistin, Faton Topalli, autori, Christian Staub